



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Nr 12 prot
Date 22.05.2024

VENDIM

Nr. 7, datë 20/05/2024

“PËR

**KORRIGJIMIN E GABIMIT NË “LEJEN PËR PËRDORIM BURIMI
UJOR NËNTOKËSOR” TË MIRATUAR ME VENDIM NR. 19, DATË
20.05.2022, SUBJEKTIT “ARSENI SH.P.K”**



Bazuar në pikën 2, neni 50, të ligjit 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, si dhe në pikën 1 e 2, nenit 112, të Kodit të Procedurave Administrative: "Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ, me kërkesë të Subjektit dhe me aprovim të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore pasi konstatoi se kërkesa e subjektit qëndron dhe pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e gabimit material, Këshilli i Basenit Ujor Drin Bunë,

V E N D O S I:

1. Korrigjimin e gabimit material në “Lejen për përdorim burimi ujor nëntokësor”, me Nr serie 000167, miratuar me vendim nr.19, datë 20.05.2022”, të Këshillit të Basenit Ujor Drin Bunë, shoqërisë “ARSENI shpk”:
Në specifikimin (Lloji i aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji), është bërë gabimi material “PËR UJË TË AMBALAZHUAR”, ndërkohë që duhet të jetë “PËR UJË TË AMBALAZHUAR (ambalazhim uji në shishe ose enë dhe pijesh jo alkoolike).
2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

